



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
SENATI

Nr. 2505 prot.

Shkodër, më 24. 09. 2020

V E N D I M

Nr. 293, datë 24. 09. 2020

"Për ndryshimin e Vendimit të Senatit Akademik nr. 172, datë 26.05.2020 "Për miratimin e mbylljes së procesit mesimor në USH "Luigj Gurakuqi" për vitin akademik 2019-2020 "

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, dt 22.07.2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", neni 38; Statutit të USH-së neni 17, me propozim të Rektoratit, Senati Akademik, në mbledhjen e tij të datës 24.09.2020

Vendosi:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 172, datë 26.05.2020 "Për miratimin e mbylljes së procesit mesimor në USH "Luigj Gurakuqi për vitin akademik 2019-2020.
2. Në fund të pikës 8 shtohet : "Në përfundim të sezonit të riprovimeve dhe para mbrojtjes së diplomave shtohen dy data vjeshte, 28 dhe 30 shtator 2020 për studentët që kanë vetëm dy provime të palikujduara."
3. Pas pikës 8 shtohet pika 8/1 : "Për studentët e vitit të parë I -rë dhe II-të bachelor dhe viti I-rë Master do të zhvillohet sezoni i riprovimeve data 12.10.2020 deri më 30.10.2020 me të drejtën për gjashtë provime në sezon."
4. Ngarkohen Njësitë kryesore për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE

Prof. dr. Suzana SOLEMI

